



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË

Adresa: Blv. "Fan Stijan Noli" Korçë

Tel +355 (0) 243366

K Ë R K E S Ë

"Për caktimin e masës së sigurimit"

**PARA :
GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË**

Në Korçë, më datë 30.04.2014, unë Dhorina Theodhori, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi studiova aktet e proçedimit penal nr. 504, viti 2014.

KONSTATOVA :

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë janë dërguar materialet hetimore nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë, me shkresën nr. 1153 prot, datë 29.04.2014 lidhur me veprën penale të « Pastrimi i produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale », e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga aktet e administruara në materialin hetimor rezulton se Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar ka marrë informacion në lidhje me shtetasin grek ~~T. M. M.~~, i datëlindjes 05.07.1962, me pasaportë greke nr. AK3526201 dhe adresë Kalavari, Greqi. Sipas këtij informacioni në datë 23.12.2013 shtetasi ~~T. M. M.~~ ka hapur llogari në Bankën Procredit (Dega Bilisht) duke deklaruar se ai merrej me shitje skrapi. Në datë 14.01.2014 i janë transferuar nga llogaria në Qipro e kompanisë "S. Business Services Ltd", rreth 28'342 euro. Dy ditë më pas në datë 16.01.2014 ka tërhequr shumën 28,000 euro. Në datë 24.04.2014 i janë transferuar po nga llogaria në Qipro e kompanisë "S. Business Services Ltd", 79'775 euro.

Kërkesa për caktimit të masës së sigurimit pasuror lidhur me proçedimin penal nr. 504, 1 viti 2014.

Për justifikimin e transaksioneve të kryera (pas kërkesës së bërë nga banka) shtetasi grek ~~Thomas Machairidis~~ ka paraqitur në Bankë një kopje të një marrëveshje huaje të datës 12.01.2014 (e lidhur vetëm dy ditë para përfitimit të transfertës së parë) sipas së cilës:

Pala huadhënëse, shoqëria "~~Sunset~~ Business Services Ltd", me seli në Belize (e themeluar në datë 08.02.2011 sipas legjislacionit të Belize me nr regjistrimi 101674), e përfaqësuar nga drejtori i menaxhimit ~~Mario P. Savand~~ ka rënë dakord që ti japë 250.000 EURO hua me interes 3 % shtetasit ~~Thomas Machairidis~~ dhe se kjo hua do ti lëvrohet në llogarinë që ~~Thomas Machairidis~~ ka në Bankën Procredit në Shqipëri.

Marrëveshja është e nënshkruar vetëm nga dy palët si dhe cilësohet që marrëveshja i nënshtrohet ligjeve të Qipros.

Nga verifikimi në emër të ~~Thomas Machairidis~~ dhe "~~Sunset~~ Business Services Ltd" nuk rezultojnë transaksione.

Nga verifikimi në sistemin TIMS rezultoi se shtetasi Thomas Machairidis të këtë kaluar në P.K.K Kapshticë (hyrje-dalje brënda ditës), vetëm në datat që ka kryer veprime në bankë, 16 janar 2014.

Bazuar në hapjen e llogarisë në një vend të ndryshëm nga vendi i rezidencës, përdorimit të llogarisë për transferimin e fondeve nga një vend off shore dhe me pas tërheqja e fondeve cash, paraqitjes së një dokumenti marrëveshje huaje e cila është e dyshimtë, lindin dyshime në lidhje me aktivitetin e kryer,

Per faktet e mesiperme organi procedues ka vendosur fillimin e hetimeve lidhur me procedimin penal nr. 504 të vitit 2014 për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale" të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në ngarkim të shtetasit ~~Thomas Machairidis~~.

Në dinamikën e kryerjes së veprimeve të ngutshme hetimore për shkak të natyrës specifike edhe të veprës penale si dhe masës së sigurimit pasuror të kërkuar, nga ana e organit procedues është kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë lidhur me faktin nëse shtetasi ~~Thomas Machairidis~~ figuron të jetë I rregjistruar ashtu sikurse ka deklaruar ai pranë bankës Procredit në Bilisht se meret me aktivitetin e shitjes së skrapit.

Në përgjigje të kësaj shkrese, Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, me shkresën nr. 6178 prot, datë 30.04.2014 ka specifikuar faktin se shtetasi ~~Thomas Machairidis~~ nuk figuron të jetë I rregjistruar as si person fizik dhe as si administrator I ndonjë subjekti.

Kërkimi I organit procedues edhe në faqen zyrtare të QKR- së ka rezultuar negative, duke konfirmuar paraprakisht faktin që ky shtetas nuk rezulton të jetë I rregjistruar si subject tregtar.

Për të gjitha arsyet e parashtruara me sipër, për të garantuar ecurinë e mëtejshme të hetimeve, prokuroria vlerëson se vendosjen e masës së sigurimit pasuror e sekuestros preventive mbi llogarinë bankare të shtetasit ~~Thomas Machairidis~~ në llogarinë e tij në Bankën Procredit (Dega Bilisht) është e domosdoshme pasi disponimi I lirë I llogarisë bankare të poseduar prej shtetasit ~~Thomas Machairidis~~ në Bankën Procredit

(Dega Bilisht) mund të vijojë zgjatjen e pasojave të veprën penale për të cilën është rregjistruar ky procedim penal.

Për sa më sipër, duke pasur parasysh rrethanat e ngjarjes, kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 274, 275, 276 të K.Pr.Penale

K Ë R K O J :

1. Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të "sekuestro preventive" të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, ndaj llogarisë bankarë të shtetasit ~~Thomas Mihalaj~~ në llogarinë e tij në Bankën Procredit (Dega Bilisht).

Kërkesës i bashkohen edhe shkresa dhe dokumenta që i përkasin procedimit penal nr.504 të vitit 2014 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

PROKURORE E CËSHTJES
Dhorina THEODHORI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Adresa: Blv. "Fan Stijan Noli" Korçë

Tel +355 (0) 243366

VENDIM

(Për pushimin e çështjes penale Nr. 504, viti 2014)

Në Korçë, viti 2016, Muaji Prill, data 29

Unë Dhorina Theodhori, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë pasi studjova aktet e procedimit penal Nr. 504 të vitit 2015:

KONSTATOVA

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë janë dërguar materialet hetimore nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë lidhur me veprën penale të « Pastrimi i produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale », e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga aktet e administruara në materialin hetimor rezulton se Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar ka marrë informacion në lidhje me shtetasin grek, ~~Thomas Machairidis~~, i datëlindjes 05.07.1962, me pasaportë greke nr. AK3526201 dhe adresë Kalavari, Greqi. Sipas këtij informacioni në datë 23.12.2013 shtetasi ~~Thomas Machairidis~~ ka hapur llogari në Bankën Procredit (Dega Bilisht) duke deklaruar se ai merrej me shitje skrapi. Në datë 14.01.2014 i janë transferuar nga llogaria në Qipro e kompanisë "Sunset Business Services Ltd", rreth 28'342 euro. Dy ditë më pas në datë 16.01.2014 ka tërhequr shumen 28,000 euro. Në datë 24.04.2014 i janë transferuar po nga llogaria në Qipro e kompanisë "Sunset Business Services Ltd", 79'775 euro.

Për justifikimin e transaksioneve të kryera (pas kërkesës së bërë nga banka) shtetasi grek ~~Thomas Machairidis~~ ka paraqitur në Bankë një kopje të një marrëveshje huaje të datës 12.01.2014 (e lidhur vetëm dy ditë para përfitimit të transfertës së parë) sipas së cilës:

Pala huadhënëse, shoqëria "Sunset Business Services Ltd", me seli në Belize (e themeluar në datë 08.02.2011 sipas legjislacionit të Belizes me nr regjistrimi 101674), e përfaqësuar nga drejtori i menaxhimit ~~Maria Pasvanti~~ ka rënë dakord që t'i japë 250.000 EURO hua me interes 3 % shtetasit Thomas Machairidis dhe kjo hua do t'i lëvrohet në llogarinë që ~~Thomas Machairidis~~ ka në Bankën Procredit në Shqipëri.

Marrëveshja është e nënshkruar vetëm nga dy palët si dhe cilësohet që marrëveshja i nënshtrohet ligjeve të Qipros.

2

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se në emër të ~~Thomas Machairidis~~ dhe "Sunset Business Services Ltd" nuk rezultojnë transaksione.

Nga verifikimi në sistemin TIMS rezultoi se shtetasi ~~Thomas Machairidis~~ të këtë kaluar në P.K.K Kapshticë (hyrje-dalje brënda ditës), vetëm në datat që ka kryer veprime në bankë, 16 janar 2014.

Bazuar në hapjen e llogarisë në një vend të ndryshëm nga vendi i rezidencës, përdorimit të llogarisë për transferimin e fondeve nga një vend "off shore" dhe me pas tërheqja e fondeve cash, paraqitjes së një dokumenti marrëveshje huaje e cila është e dyshimtë, lindin dyshime në lidhje me aktivitetin e kryer,

Per faktet e mesiperme organi procedues ka vendosur fillimin e hetimeve lidhur me procedimin penal nr. 504 të vitit 2014 per veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale" te parashikuar nga neni 287 i K.Penal, ne ngarkim te shtetasit ~~Thomas Mihal Machairidis~~.

Në dinamikën e kryerjes së veprimeve të ngutshme hetimore për shkak të natyrës specifike edhe të veprës penale si dhe masës së sigurimit pasuror të kërkuar, nga ana e organit procedues është kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë lidhur me faktin nëse shtetasi Thomas Mihal Machairidis figuron të jetë I rregjistruar si subjekt që meret me aktivitetin e shitjes së skrapit, ashtu sikurse ka deklaruar ai pranë bankës Procredit.

Në përgjigje të kësaj shkrese, Drejtorja Rajonale Tatimore Korçë, me shkresën nr. 6178 prot, datë 30.04.2014 ka specifikuar faktin se shtetasi ~~Thomas Mihal Machairidis~~ nuk figuron të jetë I rregjistruar as si person fizik dhe as si administrator I ndonjë subjekti.

Kërkimi I organit procedues edhe në faqen zyrtare të QKR- së ka rezultuar negative, duke konfirmuar paraprakisht faktin që ky shtetas nuk rezulton të jetë I rregjistruar si subjekt tregtar.

Për të gjitha arsyet e parashtruara me sipër, për të garantuar ecurinë e mëtejshme të hetimeve, prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vlerësuar se vendosja e masës së sigurimit pasuror « sekuestro preventive » mbi llogarinë bankare të shtetasit ~~Thomas Mihal Machairidis~~ në llogarinë e tij në Bankën Procredit (Dega Bilisht) është e domosdoshme pasi disponimi I lirë I llogarisë bankare të poseduar prej shtetasit ~~Thomas Mihal Machairidis~~ në Bankën Procredit (Dega Bilisht) mund të vijojë zgjatjen e pasojave të veprën penale për të cilën është rregjistruar ky procedim penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 189 Rregj, datë 02.05.2014 ka pranuar kërkesën e prokurorisë duke vendosur masën e sigurimit të sekuestros preventive mbi llogaritë bankare të shtetasit grek ~~Thomas Mihal Machairidis~~ pranë bankës "Procredit Bank", sha, dega Bilisht, në llogaritë e tij me numër : 531656420002 dhe 531656420102.

Në zbatim të këtij vendimi, prokuroria ka nxjerë urdhërin për ekzekutimin e masës së sigurimit në datën 02.05.2014, urdhër I përcjellë me shkresën nr. 2046 prot, datë 02.05.2014 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe I marë në dorëzim nga punonjësit e po kësaj banke në pot ë njëten datë në orën 14.20.

Me shkresën nr. TH3139 prot, të bankës "Procredit" Bank janë dërguar pranë organit procedues lëvizjet në llogarinë bankare numër : 531656420002 dhe 531656420102, në emër të shtetasit grek ~~Thomas Mihal Machairidis~~. Nga studimi I këtyre të dhënave rezulton se në datën 09.05.2014 (7 ditë pasi gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur masën e sigurimit pasuror të

sekuestros preventive mbi llogarinë bankare të shtetasit ~~Thomas Michael Machairidis~~ (titullari I depozitës ka tërhequr 2 (dy herë) shuma prej 40.000 eurosh, pra në një total prej 80.000 eurosh.

Për të saktësuar kushtet dhe rrethanat në të cilat rezulton te jetë kryer një veprim I tillë I kundraligjshëm, organi procedues ka kërkuar informacion pranë bankës Procredit Bank. Kjo e fundit me shkresën nr. TH 4868 prot, datë 11.09.2014 ka konfirmuar faktin se shkresa me nr. 2046 prot, datë 02.05.2014, e cila mbante edhe shkurtimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është marë në dorëzim nga ana e punonjësve të degës së bankës në Korçë në datën 02.05.2014. Këta punonjës e kanë protokolluar shkresën dhe e kanë nisur brenda ditës në Drejtorinë e Përgjithshme të bankës në Tiranë, në Njësinë e Procesimit të Shërbimeve, njësi e cila është përgjegjëse për të gjithë bankën për marrjen e masave të bllokimit në llogaritë e klientëve dhe kthimin e përgjigjeve me shkrim cdo autoriteti që urdhëron bllokime apo masa të tjera. Nga ana e punonjësve të Njësisë e Procesimit të Shërbimeve, për shkak të fluksit të madh të shkresave është mundur të procesohet vetëm në datën 13.05.2014, datë në të cilën është bërë bllokimi I llogarisë dhe kthimi I përgjigjes për prokurorinë.

Referuar process-verbalit për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale, të datës 02.09.2014 konfirmohet fakti se punonjësit e bankës "Procredit Bank", sha, Korçë kanë përcjellë në datën 02.05.2014, ora 2.47 PM, pra rreth 30 minuta pasi shkresa prokurorisë ka mbëritur në institucionin e tyre praktikën e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Në këto kushte organi procedues ka vlerësuar se punonjësit e Njësisë së Procesimit të Shërbimeve pranë Drejtorinë e Përgjithshme të bankës "Procredit Bank", në Tiranë, në kundërshtim me ligjin dhe vendimit të gjykatës kanë bllokuar rreth 11 (njëmbëdhjetë) ditë me vonesë llogarinë bankare në emër të shtetasit ~~Thomas Michael Machairidis~~, duke I siguruar këtij të fundit përfitimin e paligjshëm të një sasive prej 80.000 eurosh.

Për këtë arsye, në vlerësim të organit procedues ata kanë konsumuar elementët e veprës penale të Shpërdorimi I detyrës, e parashikuar nga neni 248 I Kodit Penal : *"Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepra tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.*

Referuar të gjitha provave të administruar në dosjen hetimore rezulton se personat përgjegjës për kryerjen e veprimit të paligjshëm janë punonjëset e e Njësinë e Procesimit të Shërbimeve pranë Drejtorinë e Përgjithshme të bankës "Procredit Bank", në Tiranë.

Në zbatim të nenit 76/1 të K.P.Penale parashikohet se: *"Kompetenca tokësore përcaktohet, me rradhë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryehet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja".*

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, e cila disiplionon në mënyrë të posacme kompetencën tokësore, organi procedues ka konkluduar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është prokuroria kompetente që duhet të hetojë mbi përgjegjësinë penale të punonjësve të cituara më sipër dhe për këtë

shkak me vendimin e datës 16.09.2015 është vendosur moskompetenca tokësore e procedimit penal nr. 504/1 e vitit 2014 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke kaluar aktet pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 4

Nga veprimet e metejshme hetimore ka rezultuar se në datë 29.08.2014 i janë transferuar nga llogaria në Qipro e kompanisë "~~Sansel~~ Business Services Ltd" në llogari në Bankën Procredit nje shume prej rreth 40.000 euro (konkretisht 39,862.00 euro).

Nga shkresa Nr. 6178 prot, datë 30.04.2014 e Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe rezulton se personi "~~Thomas Machairidis~~" nuk rezulton i rregjistruar as si person fizik dhe as si administrator i ndonje subjekti juridik dhe gjithashtu nga shkresa Nr.9225 Prot, date 17.06.2014 e Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe ky shtetas nuk figuron i rregjistruar prane D.R.T.

Nga shkresa Nr.2889/1 Prot.date 12.06.2014 e Drejtorise Rajonale Korçe rezulton se shtetasi ~~Thomas Michael Machairidis~~ nuk ka mjet ne pronesi.

Nga shkresa Nr. 2706/1 Prot.date 17.06.2014 e Zyres se Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Korçe rezulton se ne emer te subjektit Thomas Michael Machairidis nuk rezultojne pasuri te paluajtshme.

Nga shkresa Nr.855/1 Prot.date 17.06.2014 e ALUIZNIT Korçe rezulton se ne emer te shtetasit ~~Thomas Michael Machairidis~~ nuk figuron i rregjistruar asnje vetedeklarim per legalizim.

Nga shkresa Nr.2949/1 Prot.date 17.06.2014 e ALUIZNIT Korçe rezulton se: shtetasi ~~Thomas Michael Machairidis~~ nuk ka aplikuar ne sportelet e QKL-se ne cilesine e perfaqsesit ligjor, personit fizik ose personit te autorizuar per t'u pajisur me licence apo leje.

Nga pergjigjet e derguara nga bankat e nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise rezulton se shtetasi ~~Thomas Michael Machairidis~~ nuk ka apo nuk ka pasur marredhenie me keto banka.

Në kuadër të veprimeve hetimore, që po kryen nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, me qëllim dokumentimin e plotë të veprave penale, vënien para përgjegjësisë së autorëve, ka qënë e domosdoshme ndihma juridike e autoriteteve të Qipros. Ndhma juridike ka konsistuar në dërgimin e informacioneve të mëposhtme.

- Kopje të praktikës (dokumentat identifikues të dorëzuara prej palëve) së lidhjes së kontratës, datë 12.01.2014, me palë huadhënëse, shogërinë "~~Sansel~~ Business Services Ltd", me seli në Belize (e themeluar në datë 08.02.2011 sipas legjislacionit të Belize me nr. regjistrimi 101674), e përfaqësuar nga drejtori i menaxhimit Marie Pasvandi me objekt dhënien e një huaje prej 250.000 EURO me interes 3 % shtetasit Thomas Machairidis (nëse ekziston një kontratë e tillë); si dhe kopje të mënyrës, sasisë, vendit dhe institucionit bankar në të cilin është kryer lëvrimi I shumave të huasë apo edhe të pagesave të kryera në kuadër të kësaj marrëveshje.

Njëkohësisht prokuroria ka kërkuar ndihmë juridike edhe prej autoriteteve greke sa I takon fakteve të mëposhtme :

. Ndhma juridike ka konsistuar në dërgimin e të dhënave, dokumentave dhe informacioneve të mëposhtme që lidhen me shtetasin Thomas Mihal

Machairidis I datëlindjes 05.06.1962, me kombësi greke, me adresë fshati Kavalari, Selanik, Greqi.

- Të administrohet certifikata personale, familjare dhe dëshmia e penalitetit për shtetasin ~~Thomas Mihael Machairidis~~.
- Të merret informacion prej Bankave të nivelit të dytë, Greqi lidhur me llogaritë bankare që ka shtetasi Thomas Mihael Machairidis në këtë shtet. Të na vihen në dispozicion kopje të këtyre llogarive të shoqëruara me bilancin e veprimeve të kryera tek secila prej tyre.
- Të kërkohet informacion lidhur me pasuritë e paluajtshme të rregjistruara në emër të shtetasin ~~Thomas Mihael Machairidis~~, apo edhe veprimet e kryera me këto pasuri (shitje, blerje, dhurime, shkëmbime etj) pranë Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Greqi.
- Të merret informacion për për shtetasin ~~Thomas Mihael Machairidis~~ nëse figuron i rregjistruar vetë ose me bashkëpunëtorë në tjerë në aktivitete tregtare sipas Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit Tregtar grek.
- Të merret informacion për shtetasin ~~Thomas Mihael Machairidis~~ lidhur me aktivitetet që figurojnë të rregjistruara në ngarkim të tij subjekteve sipas Qendrës së Licensave në Greqi.
- Të merret informacion për shtetasin ~~Thomas Mihael Machairidis~~ lidhur me automjetet e rregjistruara në emër të tij në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor Greqi.
- Të merret informacion për shtetasin ~~Thomas Mihael Machairidis~~ lidhur me aktivitet e rregjistruara pranë Drejtorisë së Tatimit Taksave, Greqi, nëse ka biznese të rregjistruara, nëse rezultojnë të jetë aktivitete me fitim dhe kopje të bilancit të tyre të paktën për tre vitet e fundit.
- Të merret informacion për shtetasin ~~Thomas Mihael Machairidis~~ pranë Drejtorisë së Doganave Greqi lidhur me aktivitetet e importimit apo eksportimit që mund të kenë kryer ai si subjekt apo në bashkëpunim me persona të tretë, duke na vënë në dispozicion kopje të praktikave të zhdoganimit.
- Dërgimin e praktikave të deklaramit (nëse ekzistojnë deklarime të tilla) të bëra prej shtetasit ~~Thomas Mihael Machairidis~~ në degët doganore greke, pasi ka kaluar kufirin shqiptar të shumave në lekë ose në euro si dhe shumat përkatëse të deklaruara prej vitit 2013 – 2015.

Deri në këtë moment procedural, prej prokurorisë nuk janë administruar të ekzekutuara kërkesat për ndihmë juridike të kërkuara prej Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

I pyetur për faktet objekt hetimi, shtetasi Thomas Machairidis ka deklaruar faktet si më poshtë vijon :

“Une jam banor i qytetit të Selanikut në Greqi dhe une punoj si biznesmen në fushën e tregtimit të metaleve ku une bëj rolin e ndermjetesit pasi une ble metale të ndryshme në Greqi apo në vende të tjera të Ballkanit dhe i shes në Evropë ku behet perpunimi i tyre. Ndermarja ime në Greqi quhet ALMETAL dhe e ka qendren në qyteti i Selanikut ku është i rregjistruar dhe si biznes.

Dua të them se në ndermarrjen time ka ardhur në Janar të vitit 2014 dy here një shtetas shqiptar që me ka thënë që ai mblidhte metale në gjithë Shqipërinë dhe i shiste në Greqi, pra merrej me eksport-import të bakrit. Ai shoqërohej nga një shqiptar tjetër që dinte greqisht. Ai me ka thënë që kishte Vendim për pushimin e çështjes penale nr. 504 të vitit 2014

40 ton baker, me ka treguar fotografite dhe me ka thene qe kerkonte qe ta shisnin kete sasi bakri qe dua te theksoj ishte nje sasi shume e madhe prej 40 tonesh, fotografi te cilat e kam akoma dhe po ja u dorezoj. Dua te sqaroj se ky lloj bakri qe pashe ne fotografi ishte i lloji shume te paster si qelibar pasi ishte nje lloj bakri i vjeter qe perbehej prej enesh te vjetra qe kane nje cilesi bakri te paster. Dua te them se tashme emrat e ketyre shqiptareve nuk i mbaj mend por me kane dorezuar nje kartevizite te cilen tashme e kam humbur pasi kete gje do ta sqaroj me vone me hollesi.

Ju kam thene dy shqiptareve qe isha i interesuar qe une ta blija kete sasi bakri pasi me interesonte per biznesin tim. I jam drejtuar nje ndermarrjeje ne Qipro pra ndermarrjes ~~SUNSET~~ BUSINESS SERVICES LTD pasi me punojesit e kesaj ndermarrjeje me ka prezantuar nje i njohuri im biznesmen nga Selaniku qe rri ne Qipro pasi bankat ne Greqi kerkojne qe te vendosesh garanci pasuri te paluajtshme kurse kjo ndermarrje nuk me kerkoi garanci pasuri te paluajtshme. Ne fillim dhe kjo ndermarrje me kerkoi garanci por meqenese nderhyri i njohuri im, i cili ka dhene garanci per mua nuk me kerkuan si garanci pasuri te paluajtshme. Dua te sqaroj dhe nje fakt tjeter qe nga kjo ndermarrje jane hartuar tre kontrata kredie ne fillim nje me shumen 300.000 euro, e dyta me shumen 250.000 euro dhe e treta me shumen prej 120.000 eurosh te treja ne nje dite, pasi une nuk e dija se sa euro do te me duhej per kete pune ne Shqiperi, por une do te terhiqja aq sa me duheshin. Dua te them se ~~SUNSET~~ BUSINESS SERVICES LTD eshte nje ndermarrje e madhe me shtrirje ne shume vende te botes dhe e cila jep kredi, gjithashtu tregeton dhe bono thesari.

Dua te them se kam ardhur ne Shqiperi ne qytetin e Bilishtit dhe kam hapur nje llogari bankare ne banken ProCredit ne emrin tim.

Me pas kete llogari qe kam hapur ja kam dhene ~~SUNSET~~ BUSINESS SERVICES LTD dhe ata fillimisht me kane kaluar shumen prej 28 000 eurosh. Kam ardhur ne Shqiperi dhe me to pra me kete shume qe terhoqa ne banka Pro Credit kam dale neper Shqiperi bashke me punojesin tim Florenc Liço qe punon ne ndermarrjen time ne Selanik me qellim qe te gjenim vete metale dhe kam lene kartvizitat time ne qendra grumbullimi metalesh pasi mendoja qe skisha nevojte per ndermjetes qe te paguaja nqs do ta lidhja punen vete ne menyre te drejtperdrejte, por interesim nga vendet ku kemi shperndare kartvizitat nuk ka pasur dhe te gjitha na thoshin qe blini shume lire dhe jemi detyruar dhe kemi ikur.

Kam ardhur perseri ne Shqiperi me punojesin tim Florenc Liço qe punon ne ndermarrjen time ne Selanik dhe kemi terhequr ne banken ProCredit shumen prej 80 000 eurosh qe ishte kaluar nga ana e ndermarrjes ~~SUNSET~~ BUSINESS SERVICES LTD. Ne kete moment kam marre ne telefon ne oren 12.10 shqiptarin sipas kartvizites qe me kishte lene dhe i kam thene qe kisha eurot pasi ai me kishte kerkuar 80 000, pasi dua te sqaroj se shqiptari me kishte thene qe malli bente gjithsej 160 000 euro dhe kur te vija te kisha gjysmat per siguri. Ka komunikuar ne telefon punojesi im ~~Florence Liço~~ dhe ai shtetasi shqiptar i ka thene qe te prisnim telefon nga ai. Pas disa oresh ai na ka marre ne telefon dhe na ka thene qe nuk do te na i shiste ne bakrin pasi kishte gjetur kliente qe e blinin me çmim me me leverdi, pra me te shtrenjte. Ka qene ky momenti qe une e kam hedhur kartviziten i nevrkosur dhe i merzitur kurse persa i perket numurit te telefonit te punojesin tim Florenc Liço ai kishte marre nje numur telefoni shqiptar qe une e kam pyetur se kujt kompanie telefonike i perket, por ai tani nuk e mban mend pasi dhe ai e ka hedhur dhe per arsye se ai vjen ne Shqiperi shume rralle dhe nuk i duhet numri shqiptar si me ka

thene. Ne momentin qe shqiptari na ka marre ne telefon banka ishte mbyllur dhe une qe doja te ktheja leket ne banke nuk munda ta bej dot dhe i ka marre ne Greqi. Aktualisht ~~SUNSET~~ BUSINESS SERVICES LTD i kam shlyer vetem shumen prej 28 000 eurosh pasi 80 000 eurot e tjera i kam perdorur per veten time.

Pasi kam marre shumen prej 80000 eurosh dhe nuk kam bere dorë pune une nuk doja te merrja me euro nga ana e ~~SUNSET~~ BUSINESS SERVICES LTD pasi keto kishin interesin brenda por ata duke ju referuar marreveshjes prej 120 000 eurosh qe kishim nenshkruar me kishin derguar dhe kestin e fundit prej 40 000 eurosh, ndersa si sqarova 28 000 eurot ishine per llogari te marreveshjes prej 250 000 eurosh dhe e cila nuk eshte me vlefshme midis nesh pasi une shumen prej 28 000 eurosh ja u ktheva dhe me ta kam te vlefshme aktualisht vetem marreveshjen prej 120 000 eurosh.

Pasi nga ana e ~~SUNSET~~ BUSINESS SERVICES LTD me eshte kaluar dhe shuma prej 40 000 eurosh pavaresisht se une kisha folur me ta dhe ju kisha thene qe nuk dua me euro por ata mi derguan dhe une qe nga Greqia kam hyre nepermjet internetit ne llogarine time bankare dhe kam konstatuar se llogaria ime bankare ishte e bllokuar. Sot eshte hera e fundit qe po vij ne Shqiperi per te zgjidhur problemin qe me ka dale pasi keto 40 000 euro qe kam te bllokuar doja ti dergoja direkt ne ~~SUNSET~~ BUSINESS SERVICES LTD. Arsyeja se pse kam ardhur kaq vone per te zgjidhur kete problem ka qene se jam interesuar nga Greqia dhe kam gjetur ne Tirane nje avokat te quajtur ~~Enion Lena~~ qe nga Greqia dhe ai dinte greqisht dhe isha ne pritje qe ai te me jepte te reja per ceshtjen dhe ne fund ai na me ka thene qe do ta njoftonte shteti shqiptar per ceshtjen qe kisha por une nuk mund te prisja dot me gjate dhe jam paraqitur dhe sot ku po ju paraqes dhe nje material te pergatitur ne gjuhen shqipe per kete problem."

Gjithashtu nga ana e shtetasit grek ~~Thomas Mihael Machairidis~~ jane dorezuar nga ai vete dhe nepermjet avokatit te tij te zgjedhur me prokure te posaçme nje sere dokumentash greke te perkthyer ne gjuhen shqipe qe kane lidhje me aktivitetin qe ushtron shoqeria AL METAL Emporio Metallon Anonimos Eteria me aktivitet me object : Importe, Eksporte, tregetim dhe perpunim I metaleve te vjetra dhe materialeve te ngjashme. Ne kete dokumentacion perfshihet Çertifikata e Amzes Nr.058379804000 date 28/09/2015 e Dhomes se Industrise dhe Tregetise se Selanikut,Greqi, Buletini I Informimit Fiskal te Anetarit te Dhomes se tregetise dhe Industrise dhe Rregjistrimit te Amzes se veçante te eksportuesve, Vertetimi Nr.7063 I dates 02/06/2015 I drejtorise se pergjitheshme te Administrates Taksore, Langadha, Selanik, Greqi, Gjendja Aktive e shoqerise AL METAL EMBORIO METALON ANONIMOS ETERIA me NIPT 099772480, Shpallja e Rregjistrimit nga Dhoma e Industrise dhe Tregetise Selanik me Nr. Prot. 37793 date 18.12.2013.

Konkretisht nga ana e avokatit te shtetasit grek, Thomas Mihael Machairidis, i datëlindjes 05.07.1962, me pasaportë greke nr. AK3526201 dhe adresë Kalavari, Greqi jane dorezuar dokumentat greke si me poshte vijon:

1. Fletore zyrtare e Republikes te Greqise Nr.9212, ne te cilen vertetohet fakti se shoqeria "AL METAL" sha, me Nr. Regjistri te Shoqerive Anonime (RSHA), 47575/62/B00/0301 dhe Nr.RPT 058379804000, eshte shoqeri e regjistruar ne perputhje me ligjin ne shtetin grek, eshte themeluar ne dt.03/12/2013 dhe perfaqesues ligjor i shoqerise eshte shtetasi ~~Thomas Mihael Machairidis~~, i biri i ~~Mihael~~, i dtl.05/07/1962, i cili do te angazhoje me firmen

e tij, shoqerine ne te gjitha transaksionet. Pra shtetasi ~~Thomas Machairidis~~ do te veproje ne emer te shoqerise per arsye tregetare.

2. Shpallja e regjistrimit nga Dhoma e Industrise dhe Tregetise Selanik, me Nr.Prot. 37793, dt.18/12/2013 ne te cilin vertetohet fakti se shoqeria eshte regjistruar ne perputhje me ligjin ne kete institucion, i cili eshte paralel me QKR-ne Shqiperi, dhe ka veprimtari tregetare, e cila do te kryhet nga shtetasi i siperpermendur.
3. Buletinin e Informimit Fiskal te Anetarit te Dhomes se Tregetise dhe Industrise dhe Regjistrimit te Amzes se vecante te eksportuesve ne te cilin ~~Michael Machairidis~~ dhe te bijte (pra i ati i ~~Thomas~~), ushtron kete aktivitet prej vitit 1994.

Gjithashtu nga ana e avokatit te shtetasit grek, ~~Thomas Michael Machairidis~~, i datelindjes 05.07.1962, me pasaportë greke nr. AK3526201 dhe adresë Kalavari, Greqi jane dorezuar dokumentat greke si me poshte vijon:

1. Vertetimi Nr.7063, dt.02/06/2015, i Drejtorise se Pergjithshme te Administrates Taksore, Langadha, Selanik, Greqi, ne te cilin vertetohet fakti se shoqeria "AL METAL" sha, ushtron aktivitet edhe ne ditën e sotme e regjistruar me NIPT 099772480.
2. Gjendja Aktive e shoqerise AL METAL EMBORIO METALON ANONIMOS ETERIA, me NIPT 099772480, me date fillimi 04/12/2000, e cila verteton faktin se kjo shoqeri eshte ne aktivitet dhe ditën e sotme me aktivitet "Tregetim me shumice i hekurave te vjetra dhe metaleve scrap"
3. Shpallja e regjistrimit nga Dhoma e Industrise dhe Tregetise Selanik, me Nr.Prot.37793, dt.18/12/2013 ne te cilin vertetohet fakti se shoqeria eshte regjistruar ne perputhje me ligjin ne kete institucion, i cili eshte paralel me QKR ne Shqiperi, dhe ka veprimtari tregetare, e cila do te kryhet nga shtetasi i siperpermendur.
4. Marreveshjen e Huadhenies midis ~~Sunset~~ Bussines Services ltd dhe ~~Thomas Machairidis~~, e vulosur nga Gjykata e Limasolit, Qipro dhe e vertetuar nderkombetarisht me Vulen Apostile, sipas Konventes se Hages te 5 tetor 1961, e cila eshte ne perputhje me te Drejten Nderkombetare Tregetare.
5. Certifikate Nr. Amze 058379804000, dt.28/09/2015, te Dhomes se Industrise dhe Tregetise te Selanikut, Greqi, me të cilën vertetohet fakti se shoqeria Al Metal Emporio Metallon Anonimos Eteria, eshte themeluar dt.04/12/2000 dhe eshte regjistruar me Vendimin e Gjykes dt.04/12/2000. Ajo ka aktivitet te qendrueshem me objekt Importe, Eksporte, tregetim dhe perpunim i metaleve te vjetra dhe materialeve te ngjashme, dhe eshte regjistruar ne Buletinin e Regjistrimit te Emertimit ne amzen e vecante te eksportuesve Nr.42601 me numur te vecante te amzes se Eksportuesve Nr.E/11549 dhe Nr. te Amzes Tatimore 099772480.

Në kuptim te nenit 287 të Kodit Penal :

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

- a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër;

dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë gjer në pesë milionë lekë.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë gjer në tetë milionë lekë.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim dhe me gjobë nga tre milionë gjer në dhjetë milionë lekë.

Referuar të gjitha fakteve dhe provave që rezultuan nga hetimi I kësaj çështje penale, organi procedues vlerëson se pavarësisht procedurës së ndjekur për lëvrimin e shumave që rrjedhin nga marrëveshja e huasë nuk u konkludua në gjetjen e ndonjë indicje që të lidhte këtë transaksion me veprimtarinë e kundraligjshme të shtetasit ~~Thomas Macharidis~~, e për këtë shkak çështja penale duhet të pushohet.

Ndonëse hetimi I kësaj çështje penale është kryer brenda afatit 2 (dy) vjeçar nga data e rregjistrimit të këtij procedimi penal, prokuroria vlerëson se lidhja e marrëveshjes së huasë, objekt hetimi me Palë huadhënëse, shoqëria "Sunset Business Services ltd", me seli në Belize (e themeluar në datë 08.02.2011 sipas legjislacionit të Belizes me nr regjistrimi 101674), nuk rezulton të përbëjë anën objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal, për më tepër që gjatë hetimit të kësaj çështje penale nuk u provua lëvrimi I shumave, pjesë e kësaj huaje si transaksion për të fshehur, mbuluar, disponimin e këtyre shumave si produkt të ndonjë vepre penale. Dokumentacioni që vërteton gjendjen aktive të shoqërisë AL METAL EMBORIO METALON ANONIMOS ETERIA, me NIPT 099772480, me date fillimi 04/12/2000, e cila vërteton faktin se kjo shoqëri është në aktivitet dhe ditën e sotme me aktivitet "Tregetim me shumice i hekurave te vjetra dhe metaleve scrap" është një fakt I rëndësishëm që konfirmon faktin se aktiviteti I shtetasit ~~Thomas Macharidis~~, i biri i ~~M. Macharidis~~ i dtl.05/07/1962 është një aktivitet I ligjshëm dhe njëkohësisht edhe shkak për nënshkrimin e marrëveshjes së huasë objek hetimi.

Në këto kushte, referuar specifikisht akteve të ndihmës juridike të dërguar prej autoriteteve greke, organi procedues vlerëson se nuk provohet kryerja e veprës penale për të cilën është rregjistruar ky procedim penal.

Per sa me sipër ne mbështetje të nenit 328 pika 1 germa "dh" te K.Pr.Penale. 10


VENDOSA

1. Pushimin e çështjes penale Nr. 504 të vitit 2014, të regjistruar fillimisht për veprën penale të « Pastrimi i produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale », e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal mbështetur në nenin 328 pika 1 germa "dh" të K.Pr.Penale.

2. Shuarjen e masë së sigurimit "garanci pasurore", të vendosur mbi llogaritë bankare të shtetasit grek ~~Theodoras Miltiadis Mavridis~~, pranë bankës "ProCredit" Bank sha, Dega Bilisht në llogarinë e tij me nr . 531656420002 dhe 531656420102.

3. Me këtë vendim të njihen të interesuarit të cilët kanë të drejtën e ankimit ne gjykate.

PROKURORE E ÇËSHTJES
Dhorina Theodhori



R.